

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep.
 Dep.
 Dep.

D-P

Nr Prot.
 Br. Prot.
 Prot No. 01-3604/11

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo

Datim
 Prishtine 08.09.2011

Stranica
 Nr. pages



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	08.09.2011
REFERENC-Ë:	AKK-DP
PËR/ZATO:	z. Krunislav Zdravkovic Menagjer i Zyrës Prokurimit Komuna Shterpçës.
CC:	z. Bratislav Nikoliq Kryetari Komunës së Shterpçës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Ndërtimi i Palestrës Sportive".



I nderuar, z. Zdravkovic

Duke u bazuar në nenin 5 (pika 1.12) të Ligjit për Agjencinë nr:03/L-159, lidhur me tenderin "Ndërtimi i palestrës Sportive", me nr: 02 11 039 521 në Komunën e Shterpçës, ofronë këtë:

Opinion

Autoriteti Kontraktues Komuna e Shterpçës gjatë vitit fiskal 2011, nuk ka përgaditur Planifikimin përfundimtar të prokurimit publik me çka sipas AKK-së ka shkelur dispoziten e nenit 8 LPP-së 03/L-241i cili obligon Autoritetin Kontraktues që këtë dokument ta dorëzojë në APP mbrenda 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi ndarjet buxhetore për një vit fiskal.

AK para se të fillojë ushtrimin e çfardo aktiviteti të prokurimit konform nenit 9 të LPP-së 03/L-241, "ZKA dhe ZKF do të përgadisë dhe nënshkruajë një Deklaratë të nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve".

Nëse tenderi në fjalë është përfshirë në Planifikimin e Prokurimit atëherë dokumenti duhet të ruhet në dosje të tenderit. Nëse ky tender nuk është përfshirë në planifikim të prokurimit, atëherë ZKA i AK duhet të përgadisë dhe ta dorëzojë Deklaratën në Agjencionin e Prokurimit Publik mbrenda 5 ditëve para se Zyrtari Autorizues i Autoritetit Kontraktues të autorizoj Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit të prokurimit me çka sipas AKK-së, AK ka deshtuar se respektuar dispoziten e mesiperme të nenit 9.

Faqe 1 nga 1

Zyra e prokurimit në Komunën e Shterpçës si autoritet kontraktues në Dosjenë e tenderit "Punë" të procedurës së hapur me nr. të prokurimit 02 11 039 521" Ndërtimi i palestrës Sportive" në Pjesën, Seksioni II, Fleta të Dhënave të Tenderit të kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale nën 9.2 Dosjes së tenderit të pika 7 Lista e projekteve për ndërtime të larata ka kërkuar që Operatoret Ekonomik të sjellin edhe një kontratë në vlerë prej 500,000 € (Ndërtime të larata) gjë që kjo është në kundërshtim me nenin 69.6 LPP - së 03 / L-241 dispozitat e të cilit i referohen aftësive teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik.

E njëjta Zyre, gjatë të njëjtes procedure ka vepruar edhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 LPP- së 03/L-241, i cili obligon AK të trajtoj Operatoret Ekonomik në mënyr të barabart dhe jodiskriminues dhe të veprojnë në mënyr transparente.

Për të evituar shkeljet e dispozitave të lartëcekura,

R e k o m a n d o j m ë

Që ju si AK t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të lartëcekura në mënyrë që të respektohen dispozitat perkatëse të Ligjit nr. 03/L-241 të Prokurimit Publik të Kosovës.

Me respekt.